



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosovo Landfill Management Company J.S.C  
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551: 600 552  
www.kmdk-ks.org

<b>KMDK. SH.A</b>	
<small>KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD</small>	
Nr. <u>07-24/12</u>	Shtojcë
Dt. <u>13/05/2024</u>	<u>2</u>
Prishtinë	

## Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A

13.05.2024, Prishtinë

Komisioni i Ankesave i KMDK Sh.A në përbërje të plotë Edmond Halimi- kryesues, Merita Xhelili- anëtare, Lule Pashku- anëtare, dhe Endrit Vula procesmbajtës, kanë shqyrtuar Ankesën nr të protokollit të KMDK 07-14/11 e datës 03.05.2024 e parashtruar nga z.Arlind Ramadani, kandidat për pozitën “Zyrtar Ligjor” (më tutje “Ankuesi”), për çështjen juridike “Ankesë kundër vendimit të komisionit për selektim, testim, intervistim sipas konkursit publik për “zyrtar ligjor” nr 07-3916 i datës 29.04.2024”. Bazuar në vendimin e KE për formimin e komisionit të ankesave, Udhëzimin Administrativ 07/2017, Komisioni i Ankesave mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet pjesërisht Ankesa 07-14/11 e datës 03.05.2024 e z.Arlind Ramadani, kundër vendimit të komisionit për selektim, testim, intervistim sipas konkursit publik për “Zyrtar Ligjor “ nr 07-3916 i datës 29.04.2024.
2. Obligohet drejtoria e administratës të përcjellë vendimin e Komisionit të Ankesave te z.Arlind Ramadani dhe ta mbaj një kopje në dosjen e konkursit publik për “Zyrtar Ligjor”.
3. Komisioni i Ankesave merr vendim për rishpallje të konkursit për zyrtar ligjor.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga anëtarët e Komisionit të Ankesave.

### **Arsyetim**

Bazuar në të drejtën materiale dhe gjendjen faktike, pretendimet ankimore të Ankuesit nuk janë etike për shkak të mosankimimit dhe mosreagimit të menjëhershëm. Dy pretendime janë pjesërisht të bazuara, njëri jo, për shkak të keqinterpretimit të normës ligjore. Rrjedhimisht Komisioni për Ankesa vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi për shkak se:

#### **Pretendimi 1**

Komisioni i themeluar me vendimin nr 33 i datës 18.03.2024 nr protokoli 02/10/33 e kishte kryesuese znj.Lule Pashku, të cilës gjendja shëndetësore i ishte vështirësuar përnjeherë, rrjedhimisht me datë 28.03.2024 me rekomandim të specialistit neurokirurg u dërgua në pushim

mjekësor dhe trajtim të menjëhershëm. Për shkak se procedura e rekrutimit veç ishte në proces, dhe kishte pjesëmarrës të mjaftueshëm të cilët i plotësonin kushtet e konkursit publik, poashtu bazuar në nevojën imediate për zyrtar ligjor, KE i KMDK Sh.A e zëvendësoi kryesuesen Lule Pashku (femër) me Abit Aliun (mashkull) përmes vendimit me nr 41/2024 nr të protokollit 02-10/41 i datës 02.04.2024.

Ankuesi ishte ftuar për testim me shkrim, ku sipas rregullit Komisioni Përzgjedhës për Selektim, Testim dhe Intervistim prezantohet para kandidatëve të ftuar, dhe aty që në fillim është parë përbërja e komisionit por Ankuesi nuk e ka parë të arsyeshme të shfrytëzoj të drejtën e tij ligjore për të parashtruar ankesë që komisioni nuk ishte i balansuar në aspektin gjinor. Rrjedhimisht pretendimi i tillë nga Ankuesi tani pasi që nuk është përzgjedhur për pozitën e synuar nuk është kredibil dhe as etik.

Sidoqoftë, sipas Udhëzimit Administrativ 07/2017 neni 7 pika 3, Komisioni Përzgjedhës ka qenë i pa pabalansuar në aspektin gjinor rrjedhimisht pretendimi është i bazuar.

(provë: vendimet e komisioneve)

## **Pretendimi 2**

Ankuesi është njoftuar brenda afatit kohor se ka kaluar testin me shkrim dhe është ftuar përmes emailit zyrtar të merr pjesë në intervistë (me gojë). Parimisht, konkurentët që kalojnë me sukses testin me shkrim dhe ftohen për intervistim asnjëherë nuk e kërkojnë çasjen për kontrollimin e rezultateve të testit me shkrim. E njëjta ka ndodhur edhe me Ankuesin, i cili nuk ka paraqitur kërkesën e tij as me shkrim, dhe as verbalisht për çasje të vlerësimit të testit, së paku kur ka hyrë në intervistë me gojë. Komisioni Përzgjedhës ia kishte mundësuar çasjen në testin e tij, në cilën do fazë të rekrutimit, por Ankuesi nuk ka parashtruar asnjë kërkesë të tillë.

Kandidatët që nuk e kaluan testin, janë njoftuar me email zyrtar për të drejtën e shikimit të testit me shkrim në afatin e paraparë ligjor.

Bazuar në rrethanat dhe Udhëzimi Administrativ 07/2017 neni 10 pika 6, pretendimi konsiderohet si pjesërisht i bazuar, sepse është kërkesë ligjore të jepet këshillë juridike ndaj të gjithë kandidatëve njëjtë pa përjashtim.

(provë: email për ftesën e A.Ramadani i cili kaloi testin pa këshillën juridike, dhe emaili për lajmërimin e kandidates që nuk e kaloi testin me këshillën juridike)

## **Pretendimi 3**

Ankuesi pretendon në shkelje të Udhëzimit Administrativ nr 07/2017 neni 11, pika 5,7 dhe 10, të cilat nuk qëndrojnë, dhe janë të keqintepretuara.

Neni 11, pika 5, shprehimisht dhe qartë e sqaron se “Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Përzgjedhës përgatisin nga pesë (5) pyetje të veçanta për çdo pjesëmarrës në test me gojë”. Gjë

që ka ndodhur te komisioni përzgjedhës i KMDK dhe pohohet edhe në ankesën e Ankuesit, ku thuhet “çdo anëtar ka bërë nga 5 pyetje”.

Neni 11 pika 7, “Për çdo pyetje të saktë pjesëmarrësi në intervistë fiton njëzet (20) pikë. Gjithsej totali i pikëve nga intervista është njëqind (100) pikë”. Kjo pikë është respektuar nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës sepse asnjëri nga ta, as edhe kandidatit të përzgjedhur nuk i kanë dhënë mbi 100 pikë. Rrjedhimisht pretendimi i Ankuesit se komisioni ka vlerësuar kandidatët me pikë përtej maksimumit të paraparë me Udhëzimin Administrativ nuk qëndron.

Neni 11 pika 8, shprehimisht thekson “Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Përzgjedhës mbajnë shënime secili veç e veç për pyetjet e veta për çdo pjesëmarrës në intervistë, përgjigjet, pikët e fituara për çdo pyetje dhe totalin e pikëve.” Rrjedhimisht rezulton se Ankuesi e keqintepreton nenin 11 pikat 5 dhe 7, duke pretenduar se çdo anëtarë i Komisioni ka bërë vlerësimin me nga 15 pyetje për secilin kandidat të intervistuar, gjë që nuk qëndron. Cdo anëtar ka bërë vlerësimin vetëm për përgjigjet në pyetjet e veta dhe asnjëri nuk kishte tejkaluar 20 pikë për pyetje.

Poashtu pika 10 e nenit 11, është respektuar nga Komisioni Përzgjedhës sepse të gjithë kandidatët janë listuar sipas pikëve të fituara.

Nga çka u tha më lartë, asnjëra nga pretendimet e Ankuesit për shkelje të nenit 11 pikat 5,7 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ 07/2017, nuk janë të bazuara dhe nuk qëndrojnë.

### **Konkluzion**

Bazuar në administrimin e provave dhe gjendjes faktike, Komisioni i Ankesave i KMDK Sh.A me rastin e nxjerrjes së vendimit ka vepruar në pajtim me kompetencat e veta, poashtu në përputhje me Udhëzimin Administrativ 07/2017 dhe për rrjedhojë pretendimet ankimore të Ankuesit janë vlerësuar pjesërisht të bazuara, andaj Komisioni i Ankesave vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

### **Këshilla Juridike**

Nga dita e pranimit të këtij vendimi, pala e pakënaqur gëzon të drejtën e ushtrimit të ankesës në Inspektoriatin e Punës 8 ditë pas pranimit të vendimit.

### **Anëtarët e Komisionit të Ankesave**

Edmond Halimi, Kryesues

Merita Xhelili, anëtare

Lule Pashku, anëtare



### **Vendimi i dërgohet:**

Z.Arlind Ramadani

Drejtorisë së Administratës

Arkivit të KMDK Sh.A

Anëtarëve të Komisionit të Ankesave